



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 619/2021  
Datë: 24 gusht 2021

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurores Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.11 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe neneve 19 dhe 20 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor AD.nr.03/2021, të datës 23 korrik 2021, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 24 gusht 2021, në seancën e këshillimit dhe votimit morri këtë:

#### VENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr.03/2021, i datës 23 korrik 2021, ndaj prokurores Ervehe Gashi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren;
- II. **VËRTETOHET** se te prokurorja Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, nuk janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

#### ARSYETIM

Më datë 12 prill 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren Admir Shala, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj znj. Ervehe Gashi, duke propozuar që të hetohen veprimet e të njëjtës si dhe t'i shqiptohet masa "Vërejtje publike me shkrim" në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më datë 27 prill 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 12 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr vendim me numër KPK/Nr. 252/2021, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.03/2021, ndaj Prokurores Ervehe

Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Më datë 23 korrik 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD.nr.03/2021, me të cilin Paneli Hetimor i KPK-ës, ka ardhur në përfundim se në veprimet e Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, nuk është vërtetuar se ka kryer shkelje disiplinore që bien ndesh me Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror.

Sipas Raportit të Panelit Hetimor dhe prezentimit të kryesuesit të panelit, hetimi disiplinor është zhvilluar lidhur me pretendimet për tri shkelje disiplinore. Shkelja e parë e pretenduar sipas kërkesës ka të bëjë se subjekti hetimor, tani prokurorja Ervehe Gashi me datën 10 prill 2021, pa lejen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe në kundërshtim me nenin 16 të Rregullores 3/2019 të KPK-së, ka mbajtur konferencë me gazetar në hotel "Sirius" në Prishtinë. Shkelja e dytë e pretenduar ka të bëjë se gjatë asaj konference e njëjta ka ra ndesh me detyrat e punës së Prokurorit dhe paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës së prokurorit duke dhënë deklarata të pa bazuara fyese dhe shpifëse për autorin e emisionit "Kallxo përnime". Ndërsa shkelja e tretë e pretenduar është se prokurorja me dt. 07.04.2021, ka tejkalluar autorizimet e saj dhe shkelur kodin e etikës pasi që pa dijeninë e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ka komunikuar drejtpërdrejt me UD e kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, duke hedhur dyshime te kjo Gjykatë, lidhur me mos dorëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, për rastin e Sadik Hoxha, babai i Dardan Hoxhës, duke e vënë në pozitë të pabarabartë Prokurorinë me palët e tjera në procedurë, pasi që iu kishte pamundësuar ushtrimi i mjetit të jashtëzakonshëm juridik për këta dy të dënuar ku kishte kaluar afati i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, pa i vërtetuar faktet paraprakisht.

Sa i përket shkeljes së parë të pretenduar, paneli hetimor ka vërtetuar se nuk është kontestues fakti se prokurorja Gashi ka dalë në konferencë me gazetar e cila është mbajtur në hotel "Sirius" në Prishtinë. Bazuar në të gjeturat, prokurorja Gashi ka pasur një komunikim me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren, me email zyrtar dhe në llogarinë në rrjetin social viber duke i dërguar disa herë mesazhe me përmbajtje kryesisht në formë të kërkesës që Kryeprokurori të ndërmerri veprime të nevojshme për ti dal në mbrojtje prokurores Ervehe Gashi. Po ashtu, Paneli Hetimor ka vërtetuar se në rastin konkret prokurorja Ervehe Gashi para se të dal në konferencë për media me gazetar, përmes email-it zyrtar dhe sms të dërguar e ka njoftuar Kryeprokurorin se do të dal personalisht para mediave me qëllim që ta mbronte vetën nga cenimi i integritetit të saj në publik, meqë nuk kishte asnjë reagim nga ana e Kryeprokurorit.

Sipas të gjeturave nga paneli hetimor, prokurorja Gashi ka qenë e kujdesshme në trajtimin e informacioneve dhe mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve të përfshirë në atë procedurë penale sepse nuk kemi pas të bëjmë me një rast nën hetim por me një rast i

cili kishte përfunduar me vendim të formës së prerë dhe nuk ka manipuluar me ndonjë informacion relevant. E gjithë ajo çka ka deklaruar ka qenë rrjedha kronologjike e rastit dhe se si ka përfunduar procedura penale. Ndërsa sa i përket asaj se në këtë konferencë ka dalë pa pëlqimin apo autorizimin e kërkuar, nga ana e udhëheqësit, prokurorja Gashi një gjë të tillë e ka kërkuar nga Kryeprokurori por që nga komunikimet e bëra nuk kemi pas ndonjë përgjigje se e njëjta të dalë apo të mos dalë në këtë konferencë e duke e shtuar edhe faktin se qëllimi i daljes së saj ka qenë për të mbrojtur vetën nga cenimet e bëra në publik, pasi që gjatë atyre ditëve nuk kishte ndonjë reagim nga instancat me të larta.

Andaj, mbi të gjeturat si më lartë, paneli hetimor nuk ka gjetur asnjë provë që do të mbështet pretendimin e Kryeprokurorit se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitës së nenit 16 të Rregullores 3/2019 për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial dhe të Kodit të Etikës për Prokuror.

Sa i përket shkeljes së dytë të pretenduar se, gjatë konferencës për media prokurorja Ervehe Gashi ka bërë shkelje të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, duke dhënë deklarata të pabazuara fyese dhe shpifëse për Këshillin Prokurorial dhe Autorin e emisionit. Paneli hetimor pas analizimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të video konferencës, dëgjimit të subjektit të hetimit nuk ka mundur të vërtetonte pretendimet e parashtruesit përveç se, gjatë konferencës ajo ka deklaruar se ishte e detyruar që të dalë në këtë konferencë meqë deri në atë kohë as Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren e as Këshilli Prokurorial, nuk kishin bërë asnjë reagim publik me qëllim të mbrojtës së saj.

Shkelja e tretë e pretenduar nga Autoriteti Kompetent, se Prokurorja Ervehe Gashi ka rënë ndesh me kodin e etikës për prokuror pasi që e njëjta ka tejkalluar kompetencat kur pa dijeninë e Kryeprokurorit, komunikon me UD e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren duke e fajësuar apo hedhur dyshime të rënda te kjo gjykatë pa i vërtetuar mirë faktet, paneli hetimor pas analizimit të hollësishëm të shkresave nuk ka gjetur asnjë provë që do të mbështeste pretendimet e Kryeprokurorit. Sipas panelit hetimor Kodi Etikës në asnjë dispozitë të tij nuk e ndalon apo nuk e konsideron si shkelje komunikimin e prokurorit pa dijeninë e Kryeprokurorit me Kryetarin e Gjykatës. E aq më pak kur ky komunikim apo kërkesa në Gjykatë është parashtruar nga ana e prokurorit të çështjes. Ka mjaft raste në praktikë kur prokurorët e rasteve për qëllime të rasteve penale komunikojnë direkt me Gjyqtarët apo edhe me Kryetarët Gjykatave e që varët shumë se në cilin fazë të procedurës është çështja penale konkrete. Sa i përket përmbajtës së shkresës me të cilën iu është drejtuar UD. të kryetarit të Gjykatës në Prizren, pas shikimit dhe analizimit të shkresës së datës 07.04.2021, paneli hetimor në asnjë moment nuk ka gjetur se prokurorja znj. Ervehe Gashi, ka fajësuar apo ka hedhur dyshime të rënda te kjo gjykatë, pasi që e njëjta kishte kërkuar sqarim lidhur me mos dorëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit në prokurori, me të cilën i është pamundësuar paraqitja e mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Nga shkresat e lëndës është vërtetuar se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, i njëjti vendim asnjëherë nuk kishte


mbërri në zyrën e prokurores, por i njëjti është gjetur në zyrën e një prokurori tjetër, gjë që na i vërteton faktin se prokurorja Ervehe Gashi, nuk ka qenë në dijeni për këtë fakt dhe me të drejtë ka kërkuar këtë vendim.

Bazuar në të gjeturat e Panelit Hetimor, dëgjimit të subjektit të hetimit disiplinor, prezantimin e të gjitha fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me rastin AD.nr.03/2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës me shumicë votash vendosi ta aprovojë raportin e Panelit Hetimor, pasi që me provat e prezantuara është vërtetuar se në veprimet e prokurores, e cila ka qenë subjekt i hetimit disiplinor, nuk janë gjetur elemente të shkeljes disiplinore që bien ndesh me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të vlerësimit të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

  
Jetish Maloku  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'u dërgohet:

- Z. Admir Shala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren
- Znj. Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren
- Arkivit të KPK-së